

26. 09. 2018 NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL, me gjyqtarin e vetëm gjykues Ilir Bytyqi me procesmbajtësen Kadishe Shabani, zyrtare ligjore, në çështjen penale kundër të akuzuarve [REDACTED] dhe [REDACTED], për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par. 2 nenpar. 2.1 dhe 2.5 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP.nr.1950-7/16 të dt. 19.01.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik të mbajtur në praninë e përfaqësuesit të akuzës – Prokurorit të Shtetit Valdet Avdiu, të dëmtuarit [REDACTED] me av. mbrojtës [REDACTED] si dhe të pandehurit [REDACTED] [REDACTED] me av. mbrojtës [REDACTED] me datë 30.03.2018, mori dhe publikisht komunikoi, kurse me datë 20.04.2018 përpiloi me shkrim këtë:

AKTGJYKIM

Të akuzuarit:

1. [REDACTED] i lindur më [REDACTED] nga i ati [REDACTED] dhe nëma [REDACTED] e vajzërisë [REDACTED] nga Fshati [REDACTED] Komuna Ferizaj, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, në paraburgim nga data data 28.10.2016 – 08.05.2017.
2. [REDACTED] i lindur më [REDACTED] nga i ati [REDACTED] dhe nëma [REDACTED] e vajzërisë [REDACTED] me vendbanim ne Fshati [REDACTED] Komuna Ferizaj, ka të kryer shkollën e fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, në paraburgim nga data 05.11.2016 – 30.03.2018

Në kuptim te nenit 364 par. 1 pika 1. 3 të KPPRK-së,

LIROHEN NGA AKUZA

Të akuzuarit [REDACTED] dhe [REDACTED]

Se datën 21.10.2016, në kohë të pacaktuar në Fsh. [REDAKTUAR] K. Ferizaj, përkatësisht në lagjen e [REDAKTUAR] në shtëpin e të dëmtuarit [REDAKTUAR] të pandehurit në bashkëkryerje me të miturin [REDAKTUAR] me qëllim të përvetsimit të kundërligjshëm të pasurisë së luajtshme të tjetrit, me përdorimin e forcës kanë thyer dritaren e shtëpisë nga ana e pasme, kanë deportuar mbrenda në kohën kur asnjë nga familiarët nuk ishte në shtëpi, kanë shkuar në dhomën e gjumit kanë thyer derën e dhomës dhe demolojnë orendit në kërkim të parave me të cilën rast marrin parat në vlerë prej 47.000 Euro, 280 franga Zvicrrane dhe stoli ari në vlerë prej 2000 euro, si dhe një pistolet të markes PHPMV, prodhim Kroat, numer serik 05348 me shtatë fishek të kalibrit 9 mm. e cila pistolet dhe fishekët janë konfiskuar nga ana e policisë si dhe shuma e parave prej 4250 euro nga i pandehuri [REDAKTUAR].

- Me që nuk është provuar se kanë kryer veprën penale në bashkëkryerje vjedhje e rëndë nga neni 327 par. 2 nenpar. 2.1 dhe 2.5 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.
- I dëmtuari, [REDAKTUAR] me vendbanim në Fsh. [REDAKTUAR] K. Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest juridiko – civil.
- Shpenzimet e procedurës gjyqësore bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate.

Ar sy e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, me aktakuzën e evidentuar PP.nr.1950-7/16 dt. 19.01.2017, ka akuzuar të pandehurit [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] për veprën penale të vjedhjes vjedhje e rëndë nga neni 327 par. 2 nenpar. 2.1 dhe 2.5 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj çështje penale në rivendosje e konform udhëzimeve të Gjykatës së Apelit, caktoi dhe mbajti shqyrtimet gjyqësor me datat 28.02.18, 12.03.18 dhe 27.03.18, në të cilën shqyrtim përfaqësuesi i akuzës – Prokurori i Shtetit Valet Avdiu, deri në fjalën përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë aktakuzës dhe kualifikimit juridik të veprës

penale duke i propozuar Gjykatës që të akuzuarit to shpall fajtores dhe ti shqiptoj dënime sipas ligjit.

Veçimi i procedurës penale

Me aktvendim të veçantë P.nr.101/17 dt. 14.02.2017, procedura penale ndaj të pandehurve [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] është veçuar në raport me pandehurin [REDAKTUAR] (në bashkëkryerje) për faktin se ky i fundit e ka pranuar veprën penale që e ngarkon aktakuza, ndaj të cilit i është shqiptuar dënimi me burg në kohëzgjatje prej tre vite sipas aktgjykimit P.nr.1152/17 dt. 20.06.2017, i vërtetuar nga Gjykata Apelit PA1.nr.769/2017 me dt. 27.07.2017.

Provat e paraqitura në shqyrtim gjyqësor

Pasi që të akuzuarit nuk kanë pranuar fajësinë sipas pretendimeve të akuzës, Gjykata ka bërë paraqitjen e provave dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njëri me tjetrin, në kuptim të dispozitës së nenit 361 par. 1 dhe 2 të KPP-së, vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar hollësisht në dispozitën e këtij aktgjykimi.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar përmes provave të prezantuara në shqyrtimin gjyqësor dhe atë:

- pjesërisht nga mbrojtja e vet të akuzuarve gjatë shqyrtimit gjyqësor;
- përmes dëgjimit të dëshmisë së të dëmtuarit [REDAKTUAR];
- përmes shikimit dhe leximit të dy vërtetimeve mbi konfiskimin e përkohshëm të sendeve të dt. 05.11.2016;
- përmes shikimit dhe leximit të vërtetimeve mbi konfiskimin e përkohshëm të sendeve të dt. 28.10.2016;
- përmes dëgjimit të dëshmitarëve, [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] [REDAKTUAR]¹;

¹ Dëshmia e dëshmitares [REDAKTUAR] është lexuar pasi që janë plotësuar kushtet e përcaktuara me dispozitën e nenit 338 par. 1 nënpar. 1.1 dhe 1.3 të KPPK-së, andaj ardhja e saj për të dëshmuar ishte e pamundur dhe se prokurori i shtetit, avokati mbrojtës i të dëmtuarit dhe avokati mbrojtës i të pandehurit [REDAKTUAR] dhe vetë të pandehurit janë pajtuar të lexohen deklarata; ajo në hetuesi me dt. 05.11.2016 dhe ajo e shqyrtimit gjyqësor me dt. 20.04.2017.

- përmes dëshmisë së dëshmitarve kyç [REDACTED] dhe [REDACTED] (bashkëkryers dhe fill pasi i është bërë aktgjykimi i formës së prerë është dëgjuar)ky i fundit;
- përmes shikimit në fotografitë e vendit të ngjarjes.

Vlerësimi i provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Fillimisht Gjykata vlerëson si të vërtetuar dhe të pakontestueshme në aspektin objektiv përkatësisht faktet si në vijim:

- se në shtëpinë e të dëmtuarit [REDACTED] nga Fsh. [REDACTED] K. Ferizaj, fillimisht me përdorimin e forcës është thyer dritarja e shtëpisë, pastaj është depërtuar brenda e pastaj thyer edhe dera e dhomës së fjetjes ku ishin parat;
- se ishin vjedhur 47.000 euro, 280 franga zvicerane dhe stoli ari në vlerë prej 2000 euro, si dhe një pistoletë e markës PHPMV, nr. serik 05348, shtatë copë fishekë, e kalibrit 9 milimetra, prodhim Kroat;
- se nga shuma e vjedhur si më lartë, të dëmtuarit i janë k'thyer 4250 euro, pasi janë sekuestruar nga [REDACTED]
- se pistoletë e markës PHPMV, nr. serik 05348, e vjedhur në shtëpinë e të dëmtuarit është sekuestruar.

Andaj në këtë çështje penale ka qenë kontestuese vërtetimi i fakteve për implikimin e të akuzuarve përkatësisht vërtetimi i faktit se janë të akuzuarit [REDACTED] dhe [REDACTED] kryerëse e kësaj veprë penale në bashkëkryerje me të gjykuarin [REDACTED] si dhe të miturin [REDACTED] (këtë i fundit në procedurë për të mitur).

Nga përmbajtja e dëshmisë së dëshmitares – [REDACTED] (e cila dëshmi është lexuar) duke aplikuar dispozitën e nenit 338 par. 1 nënpar. 1.1 dhe 1.3 të KPP-së, meqë e njëjta nuk ka mundur të sigurohet pasi që ndaj kësaj Gjykata ka shqiptuar masën edukative institucionale – dërgim i të miturit në institucionin edukativo-korrektues në kohëzgjatje prej 1 /një/ viti (bashk. kopja e aktvendimit PM.nr.144/16 dt. 29.05.2017) dhe mbi bazë të kësaj i shmanget edhe pranimit të thirrjeve për gjykatë, nga dëshmia e saj vërtetohet se faktin se

██████████ njihet dhe shoqërohet për rreth dy /2/ vite, kanë drekuar në Shtërpçë dhe Kaçanik, pagesën e ka bërë ai, ndërsa kjo ka vazhduar për ne veturë dhe se nuk i kujtohet me çfarë bankënote ka paguar, (deri sa në hetuesi ka pohuar se pagesën e ka bërë gjithmonë me bankënot 500 euro), gjatë shoqërimit i ka parë revolen por nuk e dija se qar lloji dhe ku e ka marrë, dëshmitarja shton se nuk pa pasur njohuri që ██████████ është në kërkim nga policia dhe tri ditë kanë qëndruar në Kaçanik me ██████████, ██████████ dhe ██████████ në shtëpinë e ██████████ këtë të fundit i është bërë verifikimi për vendndodhje, por St. Policor në Kaçanik në bazë të memorandumit zyrtar dt. 27.04.2017 ka vërtetuar faktin se gjendet jashtë vendit), ██████████ ka fol për dëshirën e tij me dal jashtë shtetit, për rastin e vjedhjes në fshatin ██████████ ka dëgjuar nga nëna e saj, kjo e fundit ishte informuar nga lajmet, megjithatë përmes kësaj dëshmie vërtetohet vetëm aspekti objektiv i kësaj vepre penale ishte vjedhur në fashin ██████████ pa specifikuar vendin, kohën, sendet që ishin vjedhur apo të dëmtuarin, por pa arritur që të specifikoj se kush ishte kryerëse e kësaj vepre penale pra elementin subjektiv. Dëshmitarja as në deklaratën e hetuesisë dt. 05.11.2016 apo atë të dhënë në shqyrtim gjyqësor dt. 20.04.2017, nuk vërteton elementin subjektiv.

Nga përmbajtja e dëshmisë së dëshmitarit ██████████ në shqyrtim gjyqësor, është vërtetuar se ██████████ e ka shokë për rreth 2-3 vite, ky dëshmitar ka ditur faktin se ishte në ndjekje nga policia i pandehuri, përkundër kësaj është shoqëruar dhe nuk ka lajmëruar policinë, kanë qëndruar nëpër kafene, restorante si dhe një pjesë në Shtërpçë, i'a ka parë armën ngjyrë e zezë me nuanca të ngjyrës kafe, nuk e din se ku e ka marr, ky dëshmitar pohon edhe faktin se i pandehuri ka paguar me apoema nga 500 euro për një drekë, si dhe vetëm pas arrestimit të ██████████ ka kuptuar se është vjedhur ██████████, por megjithatë përmes kësaj dëshmie vërtetohet vetëm aspekti objektiv i një elementi se arma e vjedhur ke i dëmtuari ka qenë në posedim dhe shfrytëzim nga i pandehuri ██████████ por pa arritur që të specifikoj se kush ishte kryerëse e kësaj vepre penale meqë i njëjti për këtë vjedhje ka mësuar nga vetë i dëmtuari pasi ka takuar në lagjen e tij rastësisht si dhe nga bashkëshortja e tij kishte mësuar për faktin se nga i dëmtuari kishin blerë disa mobilje.

Nga përmbajtja e dëshmisë së dëshmitarit ██████████ në shqyrtim gjyqësor, i njëjti ka pohuar se është shoqëruar me ██████████ pasi e ka shok, kanë shëtitur dhe ngrenë dreka të cilën i ka paguar ██████████ me duket me apoema 100 euro, ██████████ i ka dhënë ta mbaj një armën mirëpo llojin nuk e din, këtë armë ia kanë marr policia, më tutje dëshmitari

pohon se ky personalisht e ka fshehur armën e të dëmtuarit dhe pasi që policia e kanë thirr ky ai tregon vendin se ku gjendet arma.

Vlerësimi i dëshmisë së këtij dëshmitari për gjykatën nuk është objektive dhe e besueshme si dhe është në kundërtënie të thellë me dëshminë e dhënë në hetuesi i njëjti dëshmitar pohon në shqyrtimin gjyqësor se ky armën e ka fshehur pasi i ka dhënë i pandehuri ■■■■■ ndërsa ne hetuesi ka vërtetuar se i pandehuri rregullisht ka pasur armën ngjyrë te zezë me dorëz të drurit në të kafet si dhe ka pasur shuma të mëdha të parave dhe posa i ka parë e ka kuptuara se ■■■■■ e ka kryer këtë vepër penale, megjithatë edhe ky dëshmiat si dy dëshmitaret e sipër cekur nuk ka arritur që të specifikoj se kush ishte kryerëse e kësaj, ndonjë veprim inkriminues apo mosveprim që kanë mundësuar në realizimin e kryerjes së veprave penale.

Gjykata, rëndësin vendimtare i kushtoj dëshmisë së të dëmtuarit ■■■■■ dëshmitarit ■■■■■ (ndaj të cilit udhëheqet procedura penale për të mitur për të njëjtën vepër penale në bashkëkrverje), si dhe dëshmisë së dëshmitarit ■■■■■ (bashkakuzuar për të njëjtën vepër penale, veçuar procedura penale me aktvendim të veçantë i gjykuar sipas aktgjykimit P.nr.1152/17 dt. 20.06.2017, i vërtetuar nga gjykata Apelit PA1.nr.769/2017 me dt. 27.07.2017).

Dëshmia e dëshmitarit ■■■■■ nga dëshmia e tij vetëm vërtetohet se ditën kritike me dt. 21.10.16, nga ora 16:30 deri 22:30, shtëpia e ka pasur të vetme, ndërsa ky gjatë tërë ditës ishte në terren Gjakovë, Pejë dhe Ferizaj, në shtëpi ka shkuar rreth orës 22, derën hyrëse të shtëpisë e ka hapur me qelës dhe ka qëndruar në sallon, duke shkruar me një myshteri e ka vër re një dritare të hapur mbrapa sallonit dritarja ka këto dimensione 1x40 me 1x20 (dëshmitari nuk dinte nëse e njëjta ka qen e hapur kur ka dal), aty ka parë edhe dy fackrrema të këmbës, mendja i kishte shkuar mos djali i tij i ka bërë, pastaj i ka ardhur bashkëshortja e cila kishte dërguar fëmijët për gjumë në katin e dytë, fillimisht e kishte parë derën e thyer te dhomës dhe ka bërtitur (përveç dhomës ku kanë qenë parat asnjë dhomë tjetër nuk ka qenë ë dëmtuar qoftë edhe dera e dhomës), i dëmtuari ■■■■■ është ngjit ne katin e dytë ku ka vërejt edhe ormanin e dëmtuar dhe këtu ishte momenti kur ka lajmëruar policin.

Dëshmitari respektivisht i dëmtuari më tutje vërteton se i janë vjedhur 47.000 Euro, 280 Franga, 200 Dollar, 20 Lira Turke dhe stoli ari (zinxhir, unaza, rreth dore) në vlerë prej 2000 euro, si dhe një pistolet të markes PPHMV, prodhim Kroat, numër serik 05348, me

dhjetë fishek, parat kanë qenë të ndara në zarfe kësisoj: 37.500 euro kanë qenë në apoema nga 500 euro, në një kuti kanë qenë 6000 euro në apoema nga 500, 100 dhe 50 euro, ndërsa një pjesë të ndara ka pasur pasaportën dhe 1050 euro si dhe në kutin e dyte ka pasur parat për pagesa të punëtorëve, në një vend 1550 euro si dhe një vend 1250 euro, nga vlera e përgjithshme e parave të vjedhura i janë k'thyer 4250 euro. Me plotësim dhe ndryshim në rivendosje thotë se i mungojnë edhe disa Dollar Amerikan 10, Lira Turke 20 dhe Lek të Shqipërisë 500, e që është në kundërtënie me shqyrtimin gjyqësor ku edhe ka mbetur në tërësi të dt. 16.03.17 ku thotë 200 Lira Turke, 200 Dollar Amerikan, (sigurisht nga jokoncentrimi).

I dëmtuari pohon se nipi i tij [REDAKTUAR] ka punuar në mobilierin e tij dhe i vetmi që ka mundur të dijë se ka para po jo edhe shumë ishte nipi [REDAKTUAR], ky i fundit është shoqëruar me Gëzimën pasi më herët kishin punuar në mobilerin [REDAKTUAR] në [REDAKTUAR], por megjithatë kjo dëshmi ishte e saktë për faktet e pohuara dhe nuk u gjet ndonjë rrethanë që do ta dëmtonte besueshmërinë e saj për më tepër kjo dëshmi është në përputhje edhe me provat materiale (përmes shikimit dhe leximit të dy vërtetimeve mbi konfiskimin e përkohshëm të sendeve të dt. 05.11.2016, përmes shikimit dhe leximit të vërtetimeve mbi konfiskimin e përkohshëm të sendeve të dt. 28.10.2016, fotografi).

Kurse përmes provave materiale (shikimi në fotografitë e vendit të ngjarjes – foto nga shtëpia pjesa e jashtme dhe e brendshme), Gjykata vlerëson se janë prova të besueshme por vërtetojnë vetëm aspektin objektiv të kësaj vepre penale se sendet janë vjedhur dhe se dera e shtëpisë respektivisht dera e dhomës ku ishin paratë ishte thyer (shihen dëmtimet) ku edhe dyshohet të jenë marrë senet e përshkruana si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, por nuk e vërtetojnë aspektin subjektiv përkatësisht faktin se kush ishte kryerësi i kësaj vepre penale.

Nga përmbajtja e dëshmisë së dëshmitarit [REDAKTUAR] (nipi i të dëmtuarit) në shqyrtim gjyqësor, është vërtetuar se ky shoqërohet me [REDAKTUAR] (i gjykuar), ky i fundit e pa pyetur në lidhje me pasurin që ka i dëmtuari dhe njëkohësisht në formë gjoja të presionit e obliguar ti tregoj edhe dhomën ku ndodhen parat, pasi [REDAKTUAR] ka marrë informacionin ditëve në vijim disa here e pyet nëse ka njeri në shtëpinë e dajës dhe në mobilieria (mobileria është në të njëjtin oborr me shtëpinë), ditën kritike dëshmitari fare nuk është takuar me asnjërin nga të pandehurit, këtë dëshmitar pas mesnatë rreth orës 01:00 e kanë marrë policia për deklaratë, i kanë marrë gjurmët e gishtërinjve dhe bërë fotografimin, aty ka kuptuar se përse

po dyshohet. Ky dëshmitar të nesërmen e thirrë [REDACTED] dhe e pyete nëse ky ka kryer vjedhjen, ndërsa [REDACTED] i thotë "tregon e dinë se qa të gjenë".

Dëshmitari më tutje pohon se, pas përfundimit të punës fillimisht ka shkuar në shtëpi dhe ka veshur rrobat pa u pastruar dhe menjëherë ka dalë për tu takuar me një shok [REDACTED] në ora 16:30 te Shkolla Teknike "Pjeter Bogdani" në Ferizaj, nga fshati [REDACTED] për në Ferizaj nuk i kujtohet nese ka udhëtuar me Taxi apo Bus, ky dëshmitar ditën kritike pra dita kur është kryer vjedhja ka marr leje nga i dëmtuari që pra orës 12:00 të lirohet - dalë nga puna e për të shkuar te mjeku, mirëpo vetë dëshmitari konfirmon se nuk ka qenë të mjeku fare, pasi dëshmitari ka ardhur në Ferizaj, me një Taxi së bashku me shokun [REDACTED] ka shkuar prapë në shtëpi për ti ndërruar teshat maicen. Ky dëshmitar vërteton edhe faktin se personat kanë hyrë nga dritarja e sallonit që lidhet me kuzhin në shtëpinë e të dëmtuarit, saktësisht nuk e ka ditur se ki janë paret mirëpo dhomën e ka ditur dhe këtë ja kishte treguar [REDACTED] rreth dy muaj para ditës kritike, [REDACTED] dhe [REDACTED] nuk kanë qenë në oborrin e [REDACTED] bile bile dëshmitari jepe një detal që në vendosjen e këtij rasti herën e parë nuk është prezantuar kur thotë se "para se me ndodhë vjedhja unë kam hyrë në dhomën e gjumit të dajës mirëpo nuk i kujtohet arsyeja" duke përshkruar në detale orenditë dhe pjesët e sendeve në atë dhomë gjumi ku i dëmtuari mbante paratë, se ky dëshmitar ka kuptuar (gjoja) se nga i dëmtuari i janë vjedhë 47.000 euro dhe menjëherë ka takuar [REDACTED] duke i kërkuar ta dijë nëse ky ka hyrë mirëpo ky i fundit i ka thënë jo dhe mos më qitë.

Dëshmitari ka prezantuar një dëshmi mjaftë të dyshimtë (për nga natyra e kuptueshme pasi është i akuzuar dhe ndaj tij udhëhiqet procedura për të mitur për këtë rast penal), te pjesa e këtij dëshmitari lindin disa pyetje që gjykata nuk ka mundur të sqaroj? Pse ky dëshmitar në momentin kur e ka përfunduar punën dhe kur ka shkuar në shtëpi fillimisht ti ndërroj teshat, nuk e ka ndërruar edhe maicen e pastaj të dele në qytet, pas qëndrimit të tij në qytet respektivisht në kafiterin Dream i lindë nevoja të hypë në taxi e të k'thehet për në shtëpi në fshatin [REDACTED] që ta ndërron vetëm atë maicë, ndërsa një pjesë e dëshmisë përputhet me kronologjinë dhe mënyrën e rastit siç e përshkruan edhe i dëmtuari, mirëpo ky dëshmitar vërteton faktin pikërisht se ky ishte personi kyç që e ka mbajtur të njoftuar të gjykuarin [REDACTED] me shtëpinë, katin, dhomën e parave, është i përfshirë drejtpërdrejt në veprën penale për të cilën vetë [REDACTED] nuk e mohon. (ndaj dëshmitar është duke u udhëheqë procedura penale për të mitur PM.nr.135/17). Mirëpo ky dëshmitar sikurse i dëmtuari (nip-dajë), nuk kanë vërtetuar elementin subjektiv të kësaj vepre penale në kuptimin të inkriminimit në përshkrimin e veprimeve.

Në fazën e plotësimit të procedurës së provave, mbrojtja e te pandehurit [REDACTED] [REDACTED] propozoi të dëgjohet në cilësinë e dëshmitarit [REDACTED] (i gjykuar me vendim të formës së prerë), për të cilën as prokurori i shtetit nuk ka kundërshtuar ndërsa gjykata ka pranuar cilësinë e dëshmitarit për faktin se objektivisht dhe subjektivisht ka marrë përgjegjësin për veprimet e tija (për çka ka marr edhe dënimin me burg 3 vite efektiv), e që ndër të tjera pohon se [REDACTED] (nipin e te dëmtuarit), e njeh që një kohe të gjatë dhe ka pasur raporte shoqërore mirëpo nga ky rast tani me i kanë ndërprerë kontaktet, po ashtu edhe [REDACTED] e ka shokë dhe komshi ndërsa me [REDACTED] janë njoftuar në burgun e Lipjanit gjatë vitit 2015. Ndërsa në muajin tetor të vitit 2016 gjatë takimeve me [REDACTED] ky i fundit e ka njoftuar se i dëmtuari [REDACTED] ka para në shtëpi, [REDACTED] i ka treguar se daja i ka 47.000 euro, ndërsa pas rastit i ka thënë se kanë qene 18.000 euro, unë fillimisht nuk e kam ditur se ku e ka shtëpinë [REDACTED] edhe përkundër asaj se është i te njëjtit fshat, po në ditën kritike pak para mbrëmjes unë jam takuar me [REDACTED] me kërkesën e këtij të fundit tek xhamia e fshatit, rithekson ky dëshmitar se para këtij takimi vetëm kishin bërë bisede për ta kryer vjedhjen dhe me tu takuar [REDACTED] ti ketë thënë po shkojmë me kry vjedhjen dhe me atë rrugë janë nisur për të shtëpia e te dëmtuarit, ky ka qëndruar mbrapa shtëpisë se te dëmtuarit ndërsa [REDACTED] ka hyrë brenda në shtëpi, [REDACTED] fillimisht ka kaluar murin e gjalle dhe ka kaluar në oborrin e te dëmtuarit, ndërsa ky ka qëndruar jashtë murit të gjalle, para se të hynë [REDACTED] në shtëpi me ka njoftuar se nuk është asnjëri aty, ora ishte në mbrëmje por nuk i kujtohet me saktësi se sa ishte, pastaj [REDACTED] ka dalur nga shtëpia e te dëmtuarit dhe i ka thënë se takohemi me vone, [REDACTED] ka qëndruar nga hyrja në shtëpi derisa sa ka dalur 10-15 min dhe i ka thënë takohemi me vone, pasi janë takuar tek xhamia [REDACTED] i kishte thënë se kanë qene 18.000 euro, kjo kishte ndodhur pas dy orëve nga momenti kur është kryer vjedhja dhe në këtë takim nga [REDACTED] ka pranuar një revole ngjyre e zeze me doreze ngjyre kafe dhe 4500 euro, dy kartë monedha që a kanë qene të Arabisë apo të Turqisë nuk e di njëra ishte në shumë 20 tjetra shumën 5.

Ky dëshmitar ditën kritike nuk ka takuar fare [REDACTED] ndërsa pas vjedhjes që kishte ndodhur e kishte takuar [REDACTED] mirëpo nuk i kujtohet data, këtë të fundit e kishte takuar në fillim të qytetit nëse nisesh nga rruga e Gremës, unë isha në këmbë ndërsa [REDACTED] ka qene me një veturë BMW 320, ngjyre e zeze, unë ja kam ngritur dorën ndërsa [REDACTED] e ka ndalur veturën dhe unë pastaj kam hipur në të dhe kemi vazhduar në drejtim të komünës me vete kam pasur revolen që me kishte dhënë [REDACTED] dhe ato dy karte

monedhat e sipër cekura, unë i kam treguar [REDACTED] se kam një revole dhe se kjo i kishte pëlqyer pastaj [REDACTED] me tha si po ja bëjmë dhe unë pastaj ja kam dhënë- falur revolen. Vlersuar ne kuptimin objektiv ky dëshmitar implikon ne elementin subjektiv vetveten si dhe te miturin [REDACTED] respektivisht nipin e te dëmtuarit i cili ishte personi i vetëm i bërjes publike te parave, vendit dhe shtëpisë e qe nga dëshmitari [REDACTED] konfirmohet qe sa bashku me te kane kryer këtë vepër penale, duke përshkruar veprimet inkriminuese rrethanat dhe natyrën se si kane ardhur deri tek realizimi i kësaj vepre penale e qe nëse e ndërldhim dëshminë e këtyre dyve aktereve kryesor nuk implikojnë ne kuptimin subjektiv te pandehurit [REDACTED] dhe [REDACTED] ne as një veprim.

Vlerësimi i vërtetimit mbi sekuestrimi e përkohshëm te sendeve te datës:28.10.2016, si prove materiale vërteton se nga i dyshuari [REDACTED] janë konfiskuar 8x100 euro, 69x50 euro ne shumen totale prej 4250 euro. Ndërsa ne vërtetimin e konfiskimit te sendeve te datës 05.11.2016, si prove materiale vërtetohet se arma e prodhimit kroat me numër serik 05348 e llojit PHMPV, kalibri 9mm është konfiskuar nga [REDACTED] mirëpo ky i fundit e ka njoftuar policinë për vendndodhjen e kësaj arme te cilën me para ne posedim e ka pasur i pandehuri [REDACTED], ndërsa ne vërtetimin tjetër mbi konfiskim po te njëjtës date 05.11.2016, vërtetohet se është konfiskuar përkohësisht një karte monedhe ne shumen prej 500 euro me numër serik X068227361167, e cila shume nuk është vërtetuar a nga i dëmtuari e as nga dëshmitarët e ekzaminuar ne këtë shqyrtim gjyqësor se kjo katre monedhe është vjedhur me shumen e parave qe i dëmtuari ka pohuar se janë vjedhur.

Ndërsa fotografit e bëra parave qe janë konfiskuar dhe te pandehurit [REDACTED] perputheñ edhe me vërtetimin mbi konfiskim edhe me vete deklaratën e te pandehurit [REDACTED] si ne hetuesi ashtu edhe gjate shqyrtimit gjyqësor, e qe këto nuk japin as një element ne raport me te pandehurit [REDACTED] dhe [REDACTED] ne inkriminim te veprës penale për te cilën i ngarkon aktakuza.

Mbrojtja e të akuzuarve

I akuzuari [REDACTED] si në fillim ashtu edhe gjate shqyrtimit gjyqësor nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale në fjalë, kurse me rastin e paraqitjes së mbrojtjes së tij ka mohuar faktin se ka vjedhur parat nga shtëpia e të dëmtuarës [REDACTED] dhe se datën kritike nuk i kujtohet ku ka qenë, [REDACTED] e ka komshi dhe njëkohësisht edhe shokë është takuar me të edhe më herët kanë biseduar gjëra të ndryshme si dhe për kerre. I

pandehuri nuk ka njohuri për këtë rast respektivisht nëse i kanë kanë përmendur emrin apo jo, ndërsa [REDACTED] e njohë kahë moti në bazë të asaj se vëllai i tij [REDACTED] ka qëndruar në të njëjtin burg dhe kur është liruar ky ka ardhur për vizitë kjo ka ngjarë rreth vitit 2013.

I akuzuari më tutje në mbrojtjen e tij pohon se me datën 21.10.2016, ka mundësi që është takuar me [REDACTED] mirëpo me datë nuk i kujtohet, para se të arrestohet ky i fundit nuk e kujton kur e ka takuar mirëpo të Marketi Bleta shpesh kanë pirë kafe.

I akuzuari [REDACTED], si në fillim ashtu edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale në fjalë, kurse me rastin e paraqitjes së mbrojtjes së tij ka mohuar faktin se ka vjedhur parat nga shtëpia e të dëmtuarës [REDACTED] dhe se duke shtuar faktin se merret me bujqësi si dhe gjatë muajit Maj e kanë shitur masën drunore mbi katër hektar në shumën prej 15.000 euro si dhe një BMW shuma e përgjithshme sipas marrëveshjes gojore ishte 20.000 euro.

I akuzuari më tutje deklaron se fare nuk ka dëgjuar se gjatë muajit Tetor të vitit 2016 ka ndodhur ndonjë vjedhje në fshatin [REDACTED] i njeh [REDACTED] [REDACTED] si dhe [REDACTED] (këtë të fundit nga burgu), më tutje i pandehuri pohon se në muajin Tetor 2016 deri sa ishte me veturë [REDACTED] e ka takuar në rrugën e qytetit respektivisht afër Komunës, [REDACTED] i ka hypë në veturën dhe pas 2-3 min. i ka treguar armën 15-qe të Kroacisë të cilën ia ka dhënë si dhe dy kartëmonedha të Turqisë bakshish-dhuratë, [REDACTED] e ka pyetur mos ka bërë ndonjë send me këtë armë mirëpo a'i thotë mos ta ndien, jam shoqëruar para arrestimit me [REDACTED] [REDACTED] si dhe [REDACTED] si dhe ka pas raste kur këtyre i kanë treguar armën, këtë armë para se të arrestohet ai ka dhënë ta mbaj [REDACTED] [REDACTED] ka pas rastin me këta tre të rrinë në Shtërpcë dhe të hamë darka e dija që ka paguar rreth 23 euro si dhe me vete ka pasur një kartëmonedhë 500 euro, një 100 euro, dy nga 50 euro, një 10 euro, këto para i ka mbetur nga shitja e zabelit-druve, me rastin e arrestimit ato para i kam pas me vete si dhe një zinxhir qafe dhe ato dy parat e Turqisë. I akuzuari një pjesë të mbrojtjes së tij e ka përqendruar në shpjegimin se është shëtitur nëpër qytet dhe nuk ka pasur dijeni se është në kërkim nga policia ndërsa shton se është arrestuar në shtëpinë e [REDACTED] [REDACTED] në Kacanik.

Vlerësimi i mbrojtjes së të akuzuarve

Mbrojtja e të akuzuarit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] në të gjitha fazat e procedurës penale janë përqendruar në kundërshtimin e fakteve se kishin kryer këtë veprë penale të përshkruar në akuzë por pa paraqitur hollësi dhe detaje për këtë çështje, mirëpo që as nga dëshmitaret e dëgjuar nuk mundemi ta vërtetojmë të kundërtën e asaj që mohohet nga të pandehurit .

Por gjykata tezës së të akuzuarve më rastin e rivendosje i beson për faktet vendimtare të kësaj çështje: cili nga dëshmitaret e dëgjuar në sallë duke përfshirë të dëmtuarin ka identifikuar të pandehurit, mjetin me të cilin supozohet ta kenë kryer veprën penale, cili nga dëshmitaret ka mundët të japë më të voglin element se të pandehurit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] janë parë në vendin e ngjarjes, janë takuar në cilin do hapësirë-palujtshmëri të të dëmtuarit, nëse i kanë parë duke hyrë nëpërmjet dritares në shtëpi, nga forenzika-krimteknika nuk është gjete ndonjë gjurmë që përputhet më të pandehurit, ndonjë kartëmonedhë e vjedhur te i dëmtuari nuk është gjetur te këta dy të pandehur.

Vlerësimi i aspektit ligjor

Gjykata në rastin konkret ka aplikuar dispozitën e nenit 262 par.1 të KPP-së, “Gjykata nuk i shpall të akuzuarin fajtor duke i dhënë rëndësi vendimtare dëshmime rrethanore dhe prove tjetër të administruar që nuk lidhen drejtpërdrejtë në inkriminim të veprës penale të pandehurit, si dhe atyre provave të cilat nuk mund të kundërshtohet nga të pandehurit ose mbrojtësi përmes marrjes në pyetje gjatë ndonjë faze të procedurës penale (kjo e fundit në rastin konkret nuk ka ekzistuar)”.

Andaj bazuar në dispozitën e lartëcekur konstatoi se në këtë çështje penale kemi vetëm dëshmi të llojit teorike (dëshminë e dëshmitarve [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR]), për më tepër provat e tjera materiale (vërtetimet mbi konfiskime dhe shikimi në fotografitë e vendit të ngjarjes) vërtetojnë vetëm aspektin objektiv të ngjarjes por nuk vërtetojnë se të akuzuarit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] në bashkëkryerje edhe me [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] kanë qënë kryerëse e kësaj veprë penale.

Analiza e fjalës përfundimtare të Prokurorit të shtetit

Prokurori i Shtetit gjatë fjalës së tij përfundimtare ka mbetur pranë aktakuzës dhe kualifikimit juridik të veprës penale duke propozuar që e akuzuara të shpallet fajtores dhe të i shqiptohet dënim sipas ligjit, duke përshkruar provat materiale.

Por, në thelb nuk ka arritur që të paraqes ndonjë provë të themeltë që do të bënte të besueshëm se e akuzuarit janë kryerës të kësaj vepre penale, por, shumica e pretendimeve të tij kanë mbetur në suaza të supozimeve, pa arritur që ta tejkalojnë kufirin e dyshimit të bazuar mirë.

Fokusi i fjalës përfundimtare mbështetet në atë "adutin kryesor" (dëshminë e dëshmitarve [REDACTED] dhe [REDACTED]) dhe provat material konfiskimi i armës të vjedhur në shtëpinë e të dëmtuarit dhe të cilat do të analizojmë më hollësisht disa nga këto pretendime:

- së pari veprimin e të akuzuarve nuk janë përshkruan as në dispozitivin e aktakuzës e që nga teza e prokurorit janë përmendur në mënyrë tejet të thjeshtë dhe në vija tejet të përgjithësuara pa elaboruar në hollësi dhe detaje, për më tepër e gjithë veprimet janë përshkruan se të akuzuara "*...me përdorimin e forcës kanë thyer dritaren e shtëpisë nga ana e pasme, kanë depërtuar brenda në kohën kur asnjëri nga familjarët nuk ishte në shtëpi, kanë shkuar në dhomën e gjumit, kanë thyer derën e dhomës dhe demolojnë orenditë në kërkim të paraveme ç'rast marrin paratë në vlerë prej 47.000 Euro, 280 franga Zvicrrane dhe stoli ari në vlerë prej 2000 euro, si dhe një pistoletë të markes PHPMV, prodhim Kroat, nrumer serik 05348 me shtatë fishek të kalibrit 9 mm.*"², e që në fakt për Gjykatën është i paqartë se nga vjen ky konkludim i Prokurorit të Shtetit edhe pse është i pakontestueshëm fakti se dera e dhomës ku ndodheshin paratë ishte thyer (siç shihet edhe përmes fotografive të derës), por ka mbetur e pasqaruar se kush ishte personi që e ka thyer dhe natyrisht edhe i ka marrë paratë dhe sendet nga aty, pra nuk u vërtetua se këtë e kishte bërë e akuzuarit;

- më tutje Prokurori i Shtetit vazhdon me paraqitjen e fjalës përfundimtare se "*...nuk është kontestuese se është thyer dritaren e shtëpisë nga ana e pasme...*"³ që edhe Gjykata pajtohet plotësisht me këtë konstatim se është fakt i pakontestueshëm se nga dritarja afër kuzhinës kanë hyrë dhe depërtuar në shtëpi dhe janë marrë sendet por kjo paraqet vetëm

² Fjala përfundimtare e Prokurorit të Shtetit

aspektin objektiv të kësaj ngjarje dhe jo edhe aspektin subjektiv - personin që kanë kryer vjedhjen gjithëmon duke i referuar të pandehurve [REDACTED] dhe [REDACTED].

- po ashtu duke iu referuar dëshmisë së të dëmtuarit - dëshmitarit se: "...dëshmia e tij konsiderojmë se është provë e besueshme për faktin që i janë vjedhur sendet e përshkruar si në dispozitave, se vërtet i kishte vërë re disa fakrema të këmbëve afër dritares ku kishin depërtuar se kur kishte hyp në katin e dytë e kishte parë derën e dhomës së gjumit të thyer dhe aty i mungonin sendet dhe paratë"⁴, e që është fakt i pakontestueshëm se nipi i tij [REDACTED] ishte edhe punëtorë në mobilerin e tij (shih dëshminë e të dëmtuarit dhe vetë dëshminë e [REDACTED]), por ky fakt absolutisht nuk është e mjaftueshëm në vërtetimin e elementeve të figurës së veprës penale.

Nga të gjitha këto që u thanë më lartë e duke marrë parasysh posaçërisht faktin se Gjykata me rastin e vendosjes është e obliguar që të provoj të gjitha faktet në mënyrë të gjithanshme dhe të pa kontestueshme, në favor dhe disfavor të akuzuarit, e posaçërisht këtë duke e ndërlidhur me nenin 3 të KPPK-së, parimin e prezumimit të pafajësisë dhe parimin in dubio pro reo, se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kurse në ndërlidhje të kësaj po ashtu duke pasur parasysh faktin se të gjitha argumentet që janë "in peius" ndaj të akuzuarit duhet të vërtetohen me siguri të plotë përkatësisht përtej dyshimit të arsyeshëm (beyond reasonable doubt) dhe nëse nuk arrihet një diçka e tillë duhet konsiderohen se nuk ekzistojnë kurse për argumentet që janë "in favorem" ndaj të akuzuarit merren se ekzistojnë edhe atëherë kur janë vërtetuar me probabilitet.

Për më tepër është e pa diskutueshme se mbi kënd bie barra e provës për fajësinë e të akuzuarit dhe çdo veprim tjetër i Gjykatës do të kuptohet si e kundërt dhe në këtë mënyrë lëvizje e barrës së provës nga organi i akuzës në të akuzuarit, e cila është në kundërshtim esencial të njërit prej parimeve fundamentale të procedurës penale e përcaktuar me nenin 7 të KPPK-së dhe e garantuar edhe me nenin 6.2 të KEDLNJ.

Kërkesa pasurore – juridike dhe shpenzimet procedurale

Në kuptim të nenit 463 par. 3 të KPP-së, i dëmtuari [REDACTED], për realizimin e kërkesës pasurore – juridike udhëzohet në kontest civil.

- Konform nenit 454 par.1 të KPP-ës, shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve të kësaj Gjykate.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P.nr.22/18 datë 20.04.2018.

Zyrtare ligjore

Kadishe Shabani

Gjyqtari i vetëm gjykues

Ilir BYTYQI



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.